



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi “Bil Klinton” Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar “Bil Klinton” Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/526-070, 525-006; Fax: 038/526-169; Email: [info@iber-lepenc.org](mailto:info@iber-lepenc.org)

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, neni 21 paragrafit 4, Ligjit për Shoqëritet Tregtare, Ligjin Nr.03/L-212 i Punës, Statutit Nr.08/868, të datës 30.05.2022, të NPH “Ibër Lepenc”, si dhe Kodin e Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e mbajtur me datë 08.10.2024 miraton:

**RREGULLOREN NR.01/2024 PËR KOMPENSIMET JASHTË PAGËS BAZË DHE  
REPREZENTACIONIT NË NDËRMARRJEN PUBLIKE HIDROEKONOMIKE  
“IBËR - LEPENC” SH.A.**

PRISHTINË, TETOR 2024

**RREGULLOREN NR.01/2024 PËR KOMPENSIMET JASHTË PAGËS BAZË DHE  
REPREZENTACIONIT NË NDËRMARRJEN PUBLIKE HIDROEKONOMIKE  
“IBËR – LEPENC” SH.A.**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi dhe mbarëvajtja e procedurave dhe kushteve të qarta, konkrete, të barabarta dhe të drejta të pagave, shtesave, kompensimeve tjera jashtë pagës bazë, stimulimeve dhe reprezentacionet për secilin të punësuar në NPH “Ibër Lepenc” SH.A.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Me këtë akt rregullohen pagat mujore, shtesat, kompensimet tjera dhe stimulimet, të cilat u paguhen punëtorëve të NPH “Ibër Lepenc” Sh.A, konform obligimeve dhe përgjegjësive të tyre për kryerjen e detyrave të punës dhe konform të drejtave për realizimin e të ardhurave nga puna e tyre.
2. Ky akt vlen dhe do të zbatohet për të gjithë të punësuarit në NPH “Ibër Lepenc” SH.A.

**Neni 3  
Parimet**

1. Pagat, shtesat dhe të gjitha llojet e kompensimeve tjera/stimulimeve në NPH “Ibër Lepenc” SH.A, do të realizohen konform këtyre parimeve:
  - a) Parimi i ligjshmërisë
  - b) Parimi i proporcionalitetit

- c) Parimi i mos-diskriminimit
- d) Parimi i barazisë
- e) Parimi i transparencës
- f) Parimet tjera relevante.

#### **Neni 4**

#### **Planifikimi i buxhetit**

1. Ndërmarrja duhet të bëjë një analizë të plotë mbi planin e buxhetit për vitin vijues, përkitazi me të gjitha pagat, shtesat, kompensimet, stimulimet, reprezentacionet dhe çdo lloj transaksioni tjetër të ndërmarrjes për punëtorët e saj.
2. Plani i biznesit duhet të përfshijë përgatitjen e mirë të menaxhimit të parave, në atë mënyrë që e drejta e punëtorëve në realizimin e fryteve të punës së tyre e garantuar me ligj, si dhe stabiliteti financiar i ndërmarrjes të mos rrezikohet.

#### **KREU II PAGAT DHE KOMPENSIMET TJERA**

#### **Neni 5 E drejta në pagë dhe kompensim**

Të drejtat për pagë mujore, pagë shtesë, kompensim për punë jashtë orarit, kompensim për punë gjatë ndërrimit të natës dhe kompensimet tjera të parapara me këtë rregullore, i punësuari i realizon sipas legilsacionit në fuqi, kontratës së punës në mes të palëve kontraktuese për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, akteve të brendshme të punëdhënësit dhe akteve tjera në fuqi.

**Neni 6**  
**Paga mujore**

1. Për punën që kryen punëtori i Ndërmarrjes, merr pagën mujore konform kontratës së punës si dhe rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes, të cilat rregullojnë këtë çështje takstativisht.
2. Lartësia e pagës mujore nuk mund të caktohet nën pagën minimale të paraparë me aktet ligjore në fuqi.
3. Paga, koeficienti, janë të përcaktuara me Rregulloren Nr.08/2913, të datës 31.10.2023 për Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në Ndërmarrjen Publike Hidroekonomike "Ibër - Lepenc" Sh.A.

**Neni 7**  
**Kriteret për përcaktimin e pagës bazë**

1. Paga mujore përcaktohet në bazë të kritereve siç janë: pozita në Organogram, rëndësia e pozitës sipas rregullores për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës.
2. Kriteret e lartcekura vlerësohen nga organi kompetent i ndërmarrjes me rastin e përcaktimit të pagave bazë.

**Neni 8**  
**Procedurat e pagesës së pagave bazë dhe kompensimeve tjera**

1. Paga mujore në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, paguhet njëherë në muaj.
2. Për çdo kompensim tjetër shtesë, organi kompetent duhet të nxjerrë vendim të veçantë.
3. Pagat në Ndërmarrje paguhen përmes transferimit bankar, ndërsa regjistrat mbi pagesat i mbanë personi i autorizuar/përgjegjës.

4. Regjistri i pagave pasqyron në mënyrë të dallueshme pagën bazë, bruto dhe shtesat e tjera në mënyrë të veçantë dhe totalin e tyre.
5. Në çdo rast punëtori sipas kërkesës së tij mund të merr edhe dëshminë me të dhënat mbi pagën mujore.
6. Zyrtari i pagave është i obliguar, që me kërkesën e të punësuarit, t'i ofrojë (një dokument me shkrim apo përmes e-mailit) të dhënat se si është kalkuluar paga dhe çdo lloj kompensimi/ stimulimi tjetër.

#### **Neni 9**

#### **Kompensimi për punën me orar të plotë**

1. Për punën e kryer me orar të plotë punëtori do të merr pagën mujore sipas kategorizimit të vendeve të punës e cila është përcaktuar në bazë të rregullores për sistematizim dhe përshkrim të vendeve të punës
2. Kalkulimi i pagës mujore do të bëhet nga Departamenti i Financave dhe do të bazohet në evidencën e kohës së punës (listat e vijimit), të cilat plotësohen nga eprorët e departamenteve/ zyreve.
3. Evidencat e punës (listat e vijueshmërisë në punë) do të procedohen për kalkulim vetëm pas plotësimit, verifikimit dhe nënshkrimit nga eprorët e departamenteve/ zyreve.
4. Afati i fundit për dorëzimin e evidencave të punës të zyrtari i pagave është java e fundit e muajit, por jo më vonë se tri ditë para përfundimit të muajit.

#### **Neni 10**

#### **Paga shtesë**

I punësuari ka të drejtë në pagë shtesë në pajtim me Ligjin e Punës dhe Kontratën e Punës për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, për punën në ditët e festave shtetërore dhe për punën e ndërrimit të natës.

Te punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si vijon:

20% në orë për kujdestari;  
30% në orë për punë gjatë natës;  
30% në orë për punë jashtë orarit;  
50% në orë për punë gjate ditëve të festave;  
50% në orë për punë gjatë fundjavës.

### **Neni 11 Pagesa e ndihmës solidare**

1. Ne rast të vdekjes së punëtorit, familja e punëtorit të vdekur ka të drejtë në kompensimin e ndihmës solidare, vetëm njëherë, nga ana e NPH "Ibër Lepenc" SH.A në shumën materiale në lartësi prej 2000 (dymijë euro).
2. Në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes se punëtorit, të cilin e ka mbajt punëtori, familjes së tij i jepet ndihma vetëm njëherë në lartësi prej 500 (pesë qind) euro.
3. Anëtarë të familjes se ngushtë konsiderohen; prindërit, bashkëshortët, bashkëjetuesit, fëmijët (martesor dhe jashtëmartesor) si dhe të birësuarit, të cilët punëtori është i obliguar t'i mbajë sipas ligjit.

### **Neni 12 Kompensimet për udhëtime zyrtare**

1. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit, në shtetet tjera për qëllime zyrtare dhe në interes të ndërmarrjes do të paguhen nga ana e punëdhënësit.
2. Para çdo udhëtimi zyrtar të stafit të ndërmarrjes duhet plotësuar autorizimin për udhëtimin zyrtar.
3. Autorizimin për udhëtime zyrtare për personelin e ndërmarrjes e aprovon Kryeshefi Ekzekutiv.

4. Mëditja dhe shpenzimet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit do të paguhen në bazë të tarifave të përcaktuara me Udhëzimet Administrative dhe rregulloret e institucioneve përkatëse qendrore.
5. Arkatari është personi përgjegjës për kalkulimin dhe vërtetimin e kalkulimit të tarifës. Pas përfundimit të udhëtimit, raporti me të gjitha faturat origjinale i bashkëngjiten autorizimit/vendimit për udhëtimin zyrtar dhe dorëzohen në sektorin e financave jo më larg se 30 ditë pas realizimit të udhëtimit zyrtar.

#### **Neni 13**

##### **Shtesat për përvojen e punës**

1. Paga bazë e secilit të punësuar në NPH "Ibër Lepenc" Sh.A, rritet në bazë të përvojës së punës në masën prej zero pesë për qind (0.5%) të pagës bazë për çdo vit të plotë pune.
2. Llogaritja e shtesës në përvojen e punës bëhet nga zyrtari i pagave bazuar në vërtetimin e punësimit në dosjen e të punësuarve.
3. Ndërmarrja do të llogaris përvojë pune të kaluar në punë edhe angazhimin në luftë për veteran dhe invalid si dhe për kategoritë tjera, të cilave ligji special ua njeh të drejtën e përvojës së dyfishtë, duke llogaritur në përqindje të njëjtë si në paragrafin 1 të këtij neni.

#### **Neni 14**

##### **Shujtat ditore**

1. Ndërmarrja do të paguaj shujta ditore për punëtorët e saj (duke llogaritur një vakt në ditë), të cilat do t'u paguhen të gjithë punëtorëve për secilën ditë pune.
2. Lartësia e këtyre shujtave do të caktohet duke llogaritur një vakt ushqimi, konform gjendjes financiare të Ndërmarrjes.
3. KE paraqet kërkesë zyrtare Bordit të Drejtorëve në lidhje me lartësinë e shumës së shujtës. Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes NPH "Ibër Lepenc" Sh.A. shqyrton

kërkesën e Kryeshefit ekzekutiv dhe nxjerr vendim në përputhje me legjisacionin në fuqi.

4. Për çdo rast të mungesës në punë këto shujta nuk u takojnë të punësuarëve.
5. Zyrtari i pagave do të bëjë transferin e pagesës së shujtave në çdo fund të muajit, duke u bazuar në listën e vijueshmërisë në secilin departament, të cilën e dorëzon udhëheqësi/shefi i departamentit/zyrës.

**Neni 15**  
**Kompensimi për funksion shtesë**

1. Nëse ndërmarrja bazuar në ligjet e veçanta obligohet që të emëroj një zyrtar që të kryej detyrat dhe përgjegjësitë për të cilat zyrtari nuk i ka në përshkrimin e detyrave të punës, atëherë ndërmarrja do e kompensoj zyrtarin në vlerë prej 50 poena shtesë.

**Neni 16**  
**Reprezentacioni**

1. Në emër të përfaqësimit (reprezentacionit) nga byfeja e Ndërmarrjes, zyrtarët e lartë të ndërmarrjes, drejtorët e departamenteve, kanë të drejtë të shpenzimit deri në 40 euro në muaj.
2. Në emër të përfaqësimit (reprezentacionit), jashtë Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes ka të drejtën e shpenzimit (për dreka zyrtare) deri në 9.000 (nëntë mijë euro) në vit, ndërsa zyrtarët e lartë dhe drejtorët e departamenteve kanë të drejtën e shpenzimit (për dreka zyrtare) deri në 1200 (njëmijë e dyqind euro) në vit.
3. Në emër të përfaqësimit të Ndërmarrjes me rastin e festës së Vtitit të Ri (kalendar, fletore, lapsa, etj, stafi drejtues i Ndërmarrjes, ka të drejtën e shpenzimeve të përbashkëta deri në 9.500 (nëntë mijë e pesë qind euro) në vit.

**Neni 17**  
**Paga përcjellëse**

1. Me rastin e pensionimit të punëtorit të ndërmarrjes, ndërmarrja do e shpërblej me 3 paga mujore, bazuar në pagën e fundit që e ka realizuar.

**KREU III**  
**STIMULIMET**

**Neni 18**  
**Stimulimi grupor dhe individual për suksesin e përbashkët në punë**

1. Për suksesin dhe rezultatet e treguara brenda vtitit ndërmarrja mund të shpërblejë punëtorët e saj në vlerën monetare të cilën e miraton Bordi i Drejtoreve.
2. Po ashtu për përparimin e dukshëm në përformancën e ndërmarrjes, i cili vjen si rezultat i punës serioze, bashkëpunimit të mirë dhe përkushtimit të singertë në punë dhe detyra të punës, ndërmarrja mund të stimulojë grupe punëtorësh nga departamenti/zyra/njësia, të cilët kanë kontribuar veçanërisht në këtë drejtim.
3. Vendimi për këtë stimulim merret nga Bordi i Drejtoreve pas konsultimit me menaxhmentin.
4. Ky vendim duhet të ketë në vete shpjegimin dhe standartet mbi të cilat është bazuar.
5. Me rastin e rezultateve të jashtëzakonshme të arritura nga njësi të veçanta, të treguara në periudha të caktuara apo gjatë vitit afarist me rritjen e të hyrave, zvogëlimit të shpenzimeve dhe kursimeve, ku për rrjedhojë ndërmarrja afaron me fitim, Kryeshefi Ekzekutiv mund t'i shpërblejë punëtorët apo njësitë e veçanta apo edhe ndërmarrjen në tërësi, në formë të bonusi. Shpërblimit paraprak duhet t'i paraprijë pëlqimi i Bordit të Drejtoreve.

6. Për shkak të performancës së lartë të punës, angazhimeve të tjera shtesë jashtë detyrave të punës, Kryeshefi Ekzekutiv përzgjedh punëtorin më të dalluar të ndërmarrjes dhe të njëjtin e shpërbulen me një pagë mujore.

### Neni 19

#### Kompensimi për kushtet e tregut, vëllimit të punëve dhe ndjeshmërisë në punë

1. Ndërmarrja do të kompensoj me pagë shtesë jashtë pagës bazë profesionet deficitare bazuar në kushtet e tregut të punës, punëtorët me vëllim të lartë të punës, si dhe ndjeshmërisë në kryerjen e punës së caktuar.
2. Kryeshefi ekzekutiv do të parashtroj kërkesë me shkrim Bordit të Drejtorëve për pagesë shtesë jashtë pagës bazë për punëtorët e caktuar. Kërkesa e Kryeshefit ekzekutiv duhet që të ketë arsyetimin dhe vlerën e shtesës mbi pagën bazë.
3. Bordi i drejtorëve të ndërmarrjes e shqyrton kërkesën e Kryeshefit ekzekutiv dhe për të njëjtën vendos në mbledhje të rregullt.
4. Vlera e shtesës jashtë pagës bazë për kushtet e tregut, vëllimit të punës dhe ndjeshmërisë së punës nuk mund të kaloj shumën prej 30% të pagës bazë të punëtorit përkatës.
5. Kompensimi për kushtet e tregut, vëllimit të punëve dhe ndjeshmërisë në punë nuk mund të kaloj shumën prej 2% të buxhetit vjetor për pagë.

### Neni 20

#### Donacionet e Ndërmarrjes

1. Ndërmarrja mund të jetë donatorë për institucionet (OJQ, klubet sportive, shkollat publike) me aktivitete kulturore, sportive, sociale dhe të ngjashme
2. Vlera maksimale e donacioneve është deri në 5000 (pesë mijë) euro.

3. Vlera totale e donacioneve të dhuruara për një vit nuk mund të kaloj vlerën 0.5 % të të hyrave vjetore.
4. Institucioni duhet të paraqes kërkesë me shkrim ndërmarrjes duke e arsyetuar kërkesën për donacion.
5. Kërkesa për donacion i dërgohet Kryeshefit ekzekutiv. Kryeshefi ekzekutiv kërkesën për donacion e dërgon në mbledhjen e rregullt të Bordit të drejtorëve për shqyrtim.
6. Bordi i drejtorëve pas shqyrtimit të kërkesës nxjerr vendim për aprosimin e tërësishëm të kërkesës, aprosimin e pjesërishëm apo refuzimin e kërkesës.
7. Institucioni njoftohet me shkrim lidhur me vendimin e Bordit.

#### **Neni 21**

#### **Shfuqizimi**


1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet rregullorja e Nr.01/1738, e datës 11.06.2010 për kompensimet jashtë pagës bazë dhe reprezentacionet.

#### **Neni 22**

#### **Hyrja në fuqi**

2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Datë: 08.10.2024

Bajram MUSTAFA

Kryesues i Bordit të Drejtorëve  
të NPH "Ibër Lepenc" Sh.A.